



BASHKIA
TIRANË

Drejtuar: Operatorit ekonomik "BE-IS" shpk
Adresa: Lagjia nr.1 Pallati i Metalurgut H.1 Kukës

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Procedura e prokurimit: "Procedure e Hapur" "Rehabilitim i rrugës dhe qendrës së lagjes Sheheler".

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-94503-11-16-2018

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Qëllimi i kontratës është: "Rehabilitim i rrugës dhe qendrës së lagjes Sheheler".

Fondi limit: 25,725,518 (njëzetë e pesë milion e shtatëqind e njëzetë e pesë mijë e pesëqind e tetëmbëdhjetë) lekë pa TVSH

Burimi i financimit: vënë në dispozicion nga të ardhurat e Bashkisë së Tiranës në mbështetje të VKB Nr. 115 datë 27.09.2018, "Për disa ndryshime në Vendimin e Këshillit Bashkiak të Tiranës Nr. 132, datë 21.12.2017", për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2018-2020 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2018"

Kohëzgjatja e kontratës: 3 (tre) muaj kalendarike duke nisur nga dita e lidhjes së kontratës.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 19.12.2018, ora 11:00

Publikime të mëparshme: (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 47 datë 26.11.2018

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

çmimi më i ulët **X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. **Operatori ekonomik "Kevin Konstruksion" shpk NUIS K71401004W**

Vlera e ofertës = 0 lekë pa TVSH.

2. **Operatori ekonomik "Eurondertimi 2000" shpk NUIS K020030010**

Vlera e ofertës: 18,608,769.97 (tetëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e tetë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e nëntë pikë nëntëdhjetë e shtatë) lekë.

3. Operatori “BE-IS”shpk NUIS K71412003A

Vlera e ofertes : **21,253,476** (njëzetë e një milion e dyqind e pesëdhjetë e tre mijë e katërqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë.

4. Operatori ekonomik “Shendelli” shpk NUIS K07924803N

Vlera e ofertes: 21,500,000 (njëzetë e një milion e pesëqind mijë) lekë pa TVSH

**5. Bashkimi i Operatorëve ekonomik ”Ina”shpk & ”A.L-Asfalt”shpk
NUIS J61814009W & NUIS K81511508A**

Vlera e ofertës: 21,720,139 (njëzetë e një milion e shtatëqind e njëzetë mijë e njëqind e tridhjetë e nëntë) lekë pa TVSH

**Janë skualifikuar Operatorët ekonomik të mëposhtëm:
Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:**

**1. Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “Kevin Konstruktion” shpk
NUIS K71401004W**

- Pas hapjes së ofertave, u konstatua se shoqëria “Kevin Konstruktion” shpk ka paraqitur në sistemin elektronik vetëm Vërtetim për xhiron e tri viteve të fundit. Ky fakt i konstatuar u regjistrua në procesverbalin e vlerësimit të ofertave.
- Mungesa e dokumentacionit ligjor, ekonomik dhe teknik si dhe mungesa e ofertës ekonomike u konfirmua nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave. Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53, pika 3 dhe pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, (i ndryshuar) si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu VII, Neni 66, pika 3, KVO e shpall **të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

**2. Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “Eurondertimi 2000” shpk
NUIS K02003001O**

Operatori ekonomik “Eurondertimi 2000” shpk nuk plotëson pikën 7 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve...,ndër të tjera kërkohet 6 (gjashtë) “punonjës hekurthyes”, pasi ka deklaruar vetem 2 punonjës hekurthyes nga 6 të kërkuar.*

Operatori ekonomik “Eurondertimi 2000” shpk nuk plotëson pikën 16 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë (Shtojca 10)”* pasi për Kamionin me targë TR 1598 S, është e pavlefshme certifikata e kontrollit teknik, skaduar në datë 20.09.2018 cka bie në kundërshtim me gërmën “a”, pika 16: *“Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit; b) leje qarkullimi; c) çertifikaten e kontrollit teknik; d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e) çertifikatën për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Për mjetet e siguruara me qera duhet të paraqitet: a) dokumenti qe verteton regjistrimin e tij; b) leje qarkullimi; c) çertifikaten e kontrollit teknik, d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e) çertifikatën e për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Mjetet të shoqerohen me kontraten perkatese te qerese/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates, objekt i ketij prokurimi. Në rastin e mjeteve te tjera duhet te jene aktet e ç’doganimit ose faturat tatimore te blerjes”*.

Referuar Shtojcës 10, Operatori ekonomik ka deklaruar se disponon 1 (një) Autobot uji me targa AA 418 UC. Pas verifikimeve të dokumentacionit shoqërues për mjetin e sipërcituar, u konstatua se mjeti rezulton të jetë Autobot uji i montuar = Kamion + Depozitë uji, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 16, ku ndër të tjera përcaktohet se: *“Operatori ekonomik duhet të disponojë 1 (një) Autobot uji”*.

Pas verifikimit të Shtojcës Nr.10 dhe dokumentacionit shoqërues për mjetet e deklaruara u konstatua se Operatori ekonomik ka deklaruar mjetin bitumatriçe dhe e ka paraqitur vetëm me faturë tatimore dhe jo dokumentacioni i plotë tekniko-ligjor, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 16, ku ndër të tjera përcaktohet se: *“Operatori ekonomik duhet të disponojë 1 (një) Autobitumatriçe,”* si dhe *“Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit; b) leje qarkullimi; c) çertifikaten e kontrollit teknik; d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e) çertifikatën për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Për mjetet e siguruara me qera duhet të paraqitet: a) dokumenti qe verteton regjistrimin e tij; b) leje qarkullimi; c) çertifikaten e kontrollit teknik, d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e) çertifikatën e për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Mjetet të shoqerohen me kontraten perkatese te qerese/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates, objekt i ketij prokurimi. Në rastin e mjeteve te tjera duhet te jene aktet e ç’doganimit ose faturat tatimore te blerjes.*

Shoqëria “Eurondertimi 2000” shpk nuk ka deklaruar se disponon mjetit “Grejder”, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 16, ku ndër të tjera përcaktohet se: *“Operatori ekonomik duhet të disponojë 1 (një) “Grejder”*.

Gjithashtu shoqëria “Eurondertimi 2000” shpk nuk ka deklaruar në Shtojcën 10 se disponon 1 (një) Makineri për vendosje guardrail.

Referuar Shtojcës 10, Operatori ekonomik ka deklaruar se disponon 2 (dy) Autobetoniere me targa DR 8315 E si dhe me targa DR 0134 F, për të cilat nuk ka paraqitur Aktin e pronësisë si dhe Çertifikatë për transport mallrash brenda vëndit, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 16, gërma ‘a’.

Sa më lart, në mbështetje të Nenit 46, pika 1, gërma “b” të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe referuar Kreut III, Seksioni II, Neni 26, pika 8, gërma “c” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), të cilat parashikojnë kualifikimin për **aftësinë teknike** të kandidatëve ofertues, Operatori ekonomik “Eurondertimi 2000” shpk, referuar

Shtojcës 10 si edhe dokumentacionit shoqërues për mjetet e paraqitura, nuk ka aftësinë e duhur teknike për realizimin me sukses të kontratës.

3. Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “Shendelli” shpk NUIS K07924803N

Operatori ekonomik “Shendelli” shpk nuk plotëson pikën 7 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve..., ndër të tjera kërkohet 6 (gjashtë) “punonjës hekurthyes”, pasi ka paraqitur dokumentacion vetëm për 1 punëtor hekurthyes nga 6 të kërkuar.*

Shoqëria “Shendelli” shpk nuk ka deklaruar në Shtojcën 10 se disponon 1 (një) Makineri për vendosje guardrail e si rrjedhojë nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për të vërtetuar disponimin e saj.

Gjithashtu, shoqëria “Shendelli” shpk nuk ka deklaruar në Shtojcën 10 se disponon 1 (një) Makineri vijëzimi, e si rrjedhojë nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për të vërtetuar disponimin e saj.

Sa më lart, në mbështetje të Nenit 46, pika 1, gërma “b” të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe referuar Kreut III, Seksioni II, Neni 26, pika 8, gërma “c” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), të cilat parashikojnë kualifikimin për aftësinë teknike të kandidatëve ofertues, Operatori ekonomik “Shendelli” shpk, referuar Shtojcës 10 si edhe dokumentacionit shoqërues për mjetet e paraqitura, nuk ka aftësinë e duhur teknike për realizimin me sukses të kontratës.

4. Oferta e paraqitur nga Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Ina” shpk & “A.L-Asfalt” shpk NUIS J61814009W & NUIS K81511508A

Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Ina” shpk & “A.L-Asfalt” shpk i krijuar me Kontratën e Bashkëpunimit me Nr. 5292 Rep. Nr. 2729 Kol./1 datë 18.12.2018 nuk ka përcaktuar në këtë marrëveshje elementët konkrete që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi, çka bie në kundërshtim me VKM Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Kreu VIII, Neni 74, pika 2 ku përcaktohet se: “Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, nëse kërkohet, duke specifikuar pjesëmarrjen nëbashkimin e operatorëve ekonomikë. Në rast se bashkimi i operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi.”

Shoqëria “Ina” shpk nuk është e licensuar për kategorinë e punimeve N.S – 9A (Punime strukturore speciale), çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit,

Kapaciteti Teknik, pika 2.

Shoqëria “A.L-Asfalt” shpk nuk ka paraqitur librezën e punës për mjekun e përgjithshëm të shoqërisë, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 6.

Gjithashtu Shoqëria “A.L-Asfalt” shpk nuk ka paraqitur Çertifikatë ISO 50001-2011 (të vlefshme), çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 15.

Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Ina” shpk & “A.L-Asfalt” shpk ka deklaruar se disponon 1 (një) kamion me kapacitet mbajtës minimum 20 Ton me targa AA 684 NH. Pas verifikimeve të dokumentacionit shoqërues, u konstatua se për mjetin e sipërcituar nuk është paraqitur Akti i pronësisë, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 16, gërma “a”.

Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Ina” shpk & “A.L-Asfalt” shpk ka deklaruar se disponon 1 (një) kamionçinë me kapacitet mbajtës 3.5 – 5 Ton me targa AA 614 IU. Pas verifikimeve të dokumentacionit shoqërues, u konstatua se për mjetin e sipërcituar nuk është paraqitur Akti i pronësisë, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 16, gërma “a”.

Bashkimi i Operatorëve ekonomik ka deklaruar se disponon 1 (një) kamion me kapacitet mbajtës minimum 10 Ton me targa AA 186 AG. Pas verifikimeve të dokumentacionit shoqërues për mjetin e sipërcituar, u konstatua se, kamioni ka kapacitet mbajtës 9.7 Ton, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 16 ku ndër të tjera përcaktohet se “Operatori ekonomik duhet të disponojë 1 (një) Kamion me kapacitet mbajtës minimum 10 Ton”.

Gjithashtu për Kamionin me targa AA 186 AG nuk është paraqitur Akti i pronësisë, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 16, gërma “a”.

Bashkimi i Operatorëve ekonomik në Deklaratën për makineritë nuk ka përcaktuar vendodhjen e mjeteve të disponuara sipas Shtojcës 10, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 16, gërma “g”.

Sa më lart, në mbështetje të Nenit 46, pika 1, gërma “b” të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe referuar Kreut III, Seksioni II, Neni 26, pika 8, gërma “c” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), të cilat parashikojnë kualifikimin për aftësinë teknike të kandidatëve ofertues, Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Ina” shpk & “A.L-Asfalt” shpk , referuar Shtojcës 10 si edhe dokumentacionit shoqërues për mjetet e paraqitura, nuk ka aftësinë e duhur teknike për realizimin me sukses të kontratës.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Operatorin ekonomik “BE-IS” shpk**, me adresë: **Lagjia nr.1 Pallati i Metalurgut H.1 Kukës**, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **21,253,476** (njëzetë e një milion e dyqind e pesëdhjetë e tre mijë e katërqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH, është identifikuar si **oferta e suksesshme**.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë së Tiranës, Sheshi Skënderbej, Nd. 2,

Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 03.01.2018

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, nuk është paraqitur asnjë ankesë.

